

RAPORT

Mbi shnderimin e Shoqerise "PIRRO OIL" Shpk
nga Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (Shpk) ne Shoqeri Aksionere (Sha)

Drejtuar per vendimarrje: *

Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise (Ortakut te vetem)

- Shoqeria "Pirro Oil" Shpk me NIPT L23807003K eshte regjistruar si person juridik prane QKR ne daten 07.02.2012.
- **Objekti i veprimtarise se saj eshte:** Import-Eksport i mallrave industriale, beteri, lubrifikante, pjesae kembimi per automjete, goma, aksesore, filtra, lende e pare. Ne fushen e servisit temjeteve motorike. Organizimin e transportit te mallrave brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Grumbullim metale me ngjyre, bateri makinash te perdorura she eksportimin e tyre.
- **Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte:** Rruga nacionale Korce-Dishnice, Km 1, Korce.
- Nga njeri vit ne tjetrin Shoqeria ka ardhur duke u zgjeruar , fuqizuar dhe duke rritur kapacitetet ne veprimtarine e saj. Ne zbatim te kerkesave ligjore te percaktuara ne fushen e vajrave lubrifikante Ortaku i vetem e shoqerise ka vendosur te beje shnderimin nga Shpk ne Sha.
- **Baza ligjore** per shnderimin e shoqerise nga Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Shpk) ne Shoqeri Aksionere (Sha) eshte Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare", Titulli III, Neni 228-229 si dhe neni 107.
- Arsyeja kryesore qe behet ky zhnderrim eshte per shkak se Ligji Nr.8450 date 24.02.1999 "Per perpunimin, transportimin dhe tregetimin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre"(I ndryshuar), neni 14 paragrafi I fundit, thekson se me kete leje te vecante pajisen vetem kompanite me forme ligjore Sha . Ne kete kuader e kemi te detyrueshme te bejme shnderrimi e shoqerise.

-
- Nuk ka asnje veshtiresi financiare apo proceduriale qe na pengon ne kete shderrim.
 - Eshte kontraktuar edhe eksperti kontabel qe do te auditoje pasqyrat financiare te kompanise .
 - Nga ky shnderrim nuk preket asnje punemarres, nuk do te kete shkurtim te vendeve te punes, perkundazi do te kete shtim te numrit et punonjesve per te plotesuar nevojat e kompanise me staf. ●

ADMINISTRATORI



(Pirro LUPE)



**RAPORT
I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR
PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR**

Shoqerise "PIRRO OIL" shpk
Nipt: L23807003K
Administrator: **Pirro Lupe**
Adresa: Korce-Bulgarec-Dishnice Km1,

KORCE

Me vendimin date 04.02.2016 te asamblese se ortakut te shoqerise "PIRRO OIL" shpk Korce, eshte vendosur rritja e kapitalit themeltar nepermjet perfshirjes te fitimeve te akumuluar. Kapitali themeltar i regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit eshte 100 000 leke. Eshte bere vendimi per rritjen e kapitalit themeltar nga asambleja e ortakut nepermjet perfshirjes se fitimeve qe rezultojne te pashperndara .

Une eksperte kontabel e shoqerise kam nderin te raportoje per ekzekutimin e misionit per zmadhimin e kapitalit. Misioni konsiston ne vleresimin e vlerave te pasurise qe perbejne aktivin e shoqerise, si dhe verifikimin qe shuma e kapitaleve te veta eshte te pakten barazi me ato te kapitalit themeltar.

Per kryerjen e ketij misioni une kam pasur ne dispozicion Pasqyrat Financiare te shoqerise te mbyllur me 31.12.2014, date e mbylljes se ushtrimit te fundit, si dhe dokumenta te tjera te nevojshme per kontrollin e ketyre elementeve te ketyre Pasqyrave Financiare.

Kontrolli nga ana ime u krye ne seline e shoqerise ne Korce, ku hartohen Pasqyrat Financiare dhe dokumentat kontabel dhe na u dhane spjegime dhe dokumenta justifikues per elementet e e Pasqyrave financiare te shqyrtuar si dhe per evoluimin e situates se shoqerise suaj qysh nga data e mbylljes se ushtrimit financiar te fundit.

Ne baze te hapave te ndermarre dhe te punes se kryer, une jam ne gjendje tu bej te njohur perfundimet qe vijojne ne kuadrin e raportit te parashikuar nga ligji.

A-VLERA E PASURISE QE PERBEJNE AKTIVIN E SHOQERISE

Per shkak te natyres se operacionit te projektuar misioni im i verifikimit konsiston nevojshmerisht per te vleresuar jo aq peshen (rendesine, materialitetin) e plus vlerave eventuale te fshehta (latente) se sa per tu siguruar qe vlerat kontabile per te cilat ortaku i vetem ka marre nje vendim nuk çojne, ne fakt, ne nje mbivleresim te pasursie se shoqerise.

Pasqyrat Financiare perbehen nga elementet qe vijojne:

I. AKTIVI

Aktive afatgjata	2.059.767	
Aktive afatshkurtra	81.262.459	
Shuma e aktivitet	83.322.226	Leke.

II. PASIVI

Detyrimet:		
Detyrime Afatgjata	2.225.795	
Detyrime Afatshkurtra	68.346.571	
Shuma:	70.572.366	Leke

Shuma e aktivitet kontabel neto para zmadhimit te kapitalit rezulton: **12.749.860 Leke**

Shume qe perbehet:

Kapitalet e veta:

Kapitali i neshkruar.....	100.000
Fitime te pashperndara	5.588.548
Fitimi i vitit ushtrimor 2014.....	7.061.312

Vlersimi i çdo posti te aktivitet e pasivitet te bilancit ka qene objekt i nje shqyrtimi te vemendshem ne kushtet e paraqitura me poshte:

AKTIVET AFATGJATA

Aktivitet e trupezuara jane detajuar sipas aneksit te bilancit 31.12.2014 Ato jane paraqitur me koston e tyre historike dhe te amortizuara sipas ligjit nr.8438, date 28.12.1998 me nje vlere neto prej **2.059.767 Leke.**

Jane te dokumentuara dhe prone e shoqerise.

Vlera e aseteve te shoqerise i pergjigjet vleres kontabile te tyre ne kontabilitet.

AKTIVET AFATSHKURTRA

Aktivitet afatshkurtra perbehen :

Gjendje inventari	15.593.428	
Kerkesa per arketim mbi debitoret	44.053.706	
Likuiditete	21.615.325	
Shuma:	81.262.459	Leke.

Inventari eshte vlere reale, eshte bere inventari fizik ne fund te vitit.

Kerkesat per arketim jane te rakorduara e jane te arketueshme.

Likuiditetet te pasqyruara ne Pasqyrat Financiare rezultojne te perputhura gjendjen e arkes dhe me ekstratet e bankes 31.12.2014 dhe gjendjen e arkes ne kete date.

DETYRIMET

Ne verifikimin e kryer ne rubrikat e posteve te bilancit detyrimet perbehen nga:

Detyrime Afatgjata	2.225.795
Detyrime Afatshkurtra	68.346.571
Shuma :	70.572.366 Leke.

Verifikimi i detyrimeve nuk ka nxjerre asgje jonormale, duke pasur parasysh se deri ne nderhyrjen tone nuk morem dijeni per ndonje konflikt ose rrezik te mundshem per te ndryshuar situaten e shoqerise.

PERFUNDIMI

Ne perfundim te verifikimeve te bera duke pasur parasysh hollesite e dhena me siper une e çmoj se vlera kontabel neto e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise , ashtu siç dalin keto vlera nga Pasqyrat Financiare qe i jane aneksuar ketij raporti, jane ne pajtueshmeri me rregullat dhe parimet kontabel ne fuqi dhe perbejne nje vleresim normal dhe te arsyeshem.

B. KAPITALET E VETA DHE KAPITALI THEMELTAR

Per percaktimin e vleres se zmadhimit te kapitalit themeltar eshte ndjekur metoda e vleres neto kontabel, qe llogaritet nga aktivi real duke zbritur detyrimet aktuale te saj.

Aktivet kontabel neto	83.322.226
Detyrimet aktuale	- 70.572.366
Kapitalet e veta	12.749.860

Sa me siper:

Kapitali i regjistruar ne QKR	100.000
Fitime te pashperndara	5.588.548
Fitimi i vitit ushtrimor 2014	7.061.312

Shuma e kapitalit mbas vendimit te ortakut per zmadhim prej 3 500 000.- leke, **arrin ne 3.600.000.- Leke.** (tremilion e gjashteqind mije leke), e cila zoterohet 100% nga ortaku i vetem i saj Z. Pirro Lupe.

KONKLuzion

Mbas kalimit te shumes 3.500.000 leke ne rritjen e kapitalit, pasivi i bilancit per kapitalet e veta ne fund te vitit 2014, pa ndryshuar totalin e bilancit behet si me poshte:

<u>Nr.</u>	<u>Emertimi i llogarive</u>	<u>Ishte</u>	<u>Behet</u>
1.	Kapitali themeltar (i nenshkruar)	100.000	3.600.000
2.	Fitime te pashperndara	5.588.548	2.088.548
3.	Fitimi i ushtrimit 2014	7.061.312	7.061.312
	Totali	12.749.860	12.749.860

Me vlersimin tone ne baze te vendimit te te ortakut per *zmadhim prej 3 500 000 leke, kapitali behet 3.500.000.- Leke, dhe zoterohet 100% nga ortaku i vetem i saj Z Pirro Lupe.*

Per te qene ne pajtim me ligjin ne vertetojme se shuma e kapitaleve te veta te shoqerise, e çmuar ne baze te dokumentave per gjendjen 31.12.2014 te cilat na u komunikuan dhe ne i verifikuam, eshte me e larte nga ajo e kapitalit themeltar te shoqerise "PIRRO OIL" shpk Korce, e regjistruar ne QKR.

Korce, me 06.02.2016

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

(Etleva ASHIKU)



STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE

“PIRRO OIL” SHA

Sot ne daten 05.02.2016, në respektim te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise, hartojme Statutin per Shoqerine "PIRRO OIL " sha si vijon:

TITULLI I

Neni 1: Emertimi dhe Forma e shoqerise .

Shoqeria " PIRRO OIL" SHA , themelohet ne formen e nje sjoqerie anomnime me oferte private dhe aktiviteti I kesaj shoqerie do et rregullohet nga ky statut ne mbeshtetje te ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Emertimi " PIRRO OIL" SHA dhe emri i administratorit do te figurojne ne te gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve.

Shoqeria " PIRRO OIL" SHA e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e rregjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 2: Dokumentat Rregulluese

Dokumenti kryesor mbi et cilin bgazohet aktiviteti I Shoqerise " PIRRO OIL" SHA eshte Statuti I saj. Me ane te ketij statuti dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar rregullohet pozita ejuridike e themeluesit te shoqerise dhe punonjesve te saj, organizimi dhe objekti I veprimtarise se Shoqerise dhe ceshtjet e tjera me rendesi per aktivitetin e saj.

Neni 3: Themelues I kesaj Shoqerie eshte :

1. **Z. Pirro Lupe** , I biri I Nikolles, datelindjes 4/12/1971, lindur ne Korce dhe banues ne Korce , shtetas Shqiptar, madhor me zotesi juridike per te vepruar me Karte identiteti Nr 029215476.

Neni 4: Selia e Shoqerise.

3.1 Selia e Shoqerise eshte: *Rr.Korce –Bulgarec _Dishnice , Km 1 , Korce .*

3.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e R.SH., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 5: Forma ligjore

Shoqëria "**PIRRO OIL** " eshte shoqeri shqiptare dhe eshte krijuar si *shoqeri aksionere .*

Neni 6: Kohezgjatja.

Shoqëria ushtron veprimtarine e saj per nje *periudhe kohore te pakufizuar.* Kohezgjatja e saj mund te shkurtohet me vendim te asamblese se pergjithshme te aksionereve .

Neni 7: Objekti i Shoqerise.

Shoqëria Aksionere "**PIRRO OIL** " *sha* do të ketë për objekt aktiviteti, si më poshtë:

- ❖ *Tregeti me pakice dhe shumice te nenprodukteve te naftes dhe gazit,*
- ❖ *Transporti imallrave brenda dhe jashte territorit et Republikes se Shqiperise:*
- ❖ *Import-Eksport, i mallrave industriale, bateri, lubrifikante;*
- ❖ *Tregeti per vajra lubrifikante dhe pjese kembimi, filtra , goma per makina te te gjitha llojeve;*
- ❖ *Servis per mjete motorike;*
- ❖ *Lavazh per automjete;*
- ❖ *Bar-kafe dhe ambiente sherbimi;*
- ❖ *Grumbullim metale me ngjyre, bateri makinash te perdorura dhe eksportet e tyr;*
- ❖ *Si dhe të tjera aktivitete të përgjithshme biznesi.*

TITULLI II
KAPITALI

Neni 8: Kapitali i Shoqerise

8.1 Kapitali fillestar i Shoqerise eshte: **3.600.000 (tre milion e gjashteqindmije) leke.**

8.2 Kapitali është i shlyer teresisht. Kapitali është nënshkruar nga aksioneri i vetëm i shoqërisë Z. Pirro Lupe i cili zotëron, 100% të aksioneve të shoqërisë ose 500 (peseqind) aksione me vlerë nominale 7.200 lek secila.

8.3 Aksionet janë teresisht nominale dhe janë lirish të transferueshme, sipas ligjit në fuqi.

Aksioneri përgjigjet për humbjet e Shoqërisë përkundërt të tregjeve vetëm në vlerën e paslyer të aksioneve të nënshkruara.

8.4 Çdo aksion i jep të drejtën e një vote titullatit të tij.

8.5 Kapitali i Shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo të holla siç parashikohet në ligj.

Neni 9: Transferimi i kapitalit

Aksionet të një shoqërie aksionere mund të transferohen të tregjeve nëpërmjet shitjes dhe dhurimit pasi ato ju janë ofruar me pare aksionereve të shoqërisë (e drejta e parblerjes).

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen, personave të tregjeve që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, siç u përmend në paragrafin e mësipërm, vetëm me miratimin e shumicës së aksionereve që përfaqësojnë $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet me shkrim, me letrë rekomanduese, shoqërisë dhe secilit prej aksionereve, në të cilin të jepen njoftuar emri i personit dhe qëllimet e tij, çmimi i shitjes etj. Miratimi duhet të shprehë me shkrim nga aksionerët. Ky vendim i komunikohet brenda 10 ditësh organit administrativ. Organi administrativ duhet të bëjë të ditur këtë vendim brenda 30 ditësh aksionerit kërkuar nëpërmjet një letrë rekomanduese.

Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda 90 ditësh nga data e njoftimit të fundit sipas paragrafit të mësipërm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme nëndërmjet aksionereve.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie. Për mënyrën e realizimit të këtij transferimi duhet të merret miratimi i aksionereve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit të shoqërisë.

Neni 10 Menyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve

Aksionet e shoqërisë dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë.
- b) Shitblerjes.
- c) Dhurimit.

Aksionet e te drejtat e fituara si me sipqe nuk mund te ushtrohen ndaj asnje personi apo ndaj shoqerise, perpara se veprimi et jete rregjistruar ne rregjistrin e posacem te aksioneve qe mban shoqeria, ne perputhje me piken 1 te nenit 119 te ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

TITULLI III

ORGANET E SHOQERISE

Neni 11: Asambleja e Aksionereve

Organi themelor i Shoqerise eshte Asambleja e aksionereve .

Asambleja e Aksionereve merr vendime per:

- (1) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- (2) Ndryshimet e Statutit;
- (3) Emerimin dhe shkarkimin e anetareve te keshillit te administrimit;
- (4) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te regjistruar;
- (5) Percaktimin e shperblimeve per anetaret e keshillit te administrimit, likujduesin dhe ekspertin kontabel te regjistruar;
- (6) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave fianciare dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (7) Shperndarjen e fitimeve vjetore.
- (8) Miratimin e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (9) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- (10)Pjestimin e aksionevee dhe anulimin e tyre;
- (11)Ndryshime ne tderjat qe lidhen me aksione te llojeve e kategorive te vecanta.
- (12)Perfaqesimin e shoqerise ne gjykimet ndaj organeve te administrimit;
- (13)Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- (14)Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,
- (15)Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e aksionereve, merr vendime pas shqyrtimit et dokumentave percatese se bashku me raportin e Keshillit te administrimit dhe raportin e Ekspertit Kontabekl te Autorizuar.

Te gjitha vendimet e mara nga Asambleja e aksionereve, rregjistrohen ne nje rregjister te vendimeve te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Vendimet e parregjistruara ne rregjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme . Shoqeria nuk mund t'i kundershtojte pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirbesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te kishte pasur dijeni per te .

Neni 12: Mbledhja e asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per et mbrojtur interest e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga adminiostratoret dhe, ne rastet e parashikuara nga ligji, nga anetaret e keshillit administrativ, te keshillit mbikeqyres apo nga aksionaret e percaktuar sipas nenit 139 te ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e pergjithshme duhet te thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton apo parashikohet qarte se humbjet arrijne ne nje vlere te barabarte me 50 % te kapitalit te rregjistruar ose qe aktivet e shoqerise nuk mbulojne detyrimet, qe jane te kerkueshme brenda 3 muajve ne vijim.

Asambleja e pergjithshme duhet te thirret, kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5 te ketij neni, asamblese se pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar i pavarur.

Dispozita e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohet nese blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 te ketij neni, kryhen ne burse apo jane pjese e veprimeve te perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri 5 te ketij neni, asamblja e pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarine e organeve administrative .

Neni 13 Menyra e thirrjes.

1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkresë ose, me njoftim nepermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendin e ditës u dërgohen të gjithë aksionareve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Ky njoftim duhet te permbaje, gjithashtu: emrin e shoqerise, seline e regjistruar, vendin dhe oren e mbledhjes se asamblese, nje sqarim te hollesishem te procedurave, qe duhet te ndiqen nga aksioneret, per te marre pjese dhe votuar ne asamble, e cila duhet te perfshije :

-
- Te drejtat e aksionereve, sipas nenit 139 te ligjit per tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
 - Procedurat e votimit me prokurë , formulare te posacem, per t'u perdorur gjate votimit me prokurë dhe mjete elektronike, me te cilat shoqëria do et pranoje njoftimin e perfaqesuesve te autorizuar, procedurat per votim, me mjete elektronike apo me korrespondence.
 - Informacion per vendin e menyrat per te marre ne forme te plote dokumentet dhe projektvendimet e percaktuar ne pikat 1 e 2 te nenit 138 te ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
 - Adresen e faqes se internetit te shoqërise, ku mund te merret informacioni i percaktuar ne kete nen.
 - Njoftimi i thirrjes se asamblese se pergjithshme, se bashku me rendin e dites, vendosen edhe ne faqen e internetit et shoqërise,
3. 21 diet perpara dites se caktuar per mbledhjen e asamblese , perfshire ketu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vere en dispozicion aksionereve ne faqen e saj ne internet, te pakten informacionin vijues:
- Informacionin sipas pikave 1 e 2 te ketij neni .
 - Numrin total te aksioneve dhe te frejtave te votes qe u perkasin ketyre aksioneve ne datën e njoftimit et thirrjes se mbledhjes, perfshire shumat totale per cdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërise ndahet ne dy apo me shume kategori aksionesh.
 - Cdo dokument qe do t'i vihet ne dispozicion asamblese se pergjithshme.
4. Ne rastin kur shoqëria aksionere ka shume aksionere, thirrja e mbledhjes se asamblese se pergjithshme mund t'u njoftohet aksionereve dhe nepermjet botimit te informacioneve si me siper ne neje gazete te perditshme me shperndarjen ne te gjithe vendin.

Neni 14 Rendi i dites

Rendi i dites, qe njoftohet sipas nenit 137 te ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duhet te permbaje dhe vendimet e propozuar per cdo ceshtje.

Nese asambleja e pergjithshme duhet et vendose per ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Administratoret duhet t'i pergjigjen, me shkrim, cdo kerkese me shkrim per sqarim per rendin e dites, derguar nga aksioneret jo me vone se 8 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese se pergjithshme.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas formaliteteve te ketij neni dhe te nenit 137 te ketij ligji, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjitha aksioneret jane te pranishem dhe shprehen dakord per et marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 15 Mbledhja e asamblese se pergjithshme dhe rendi i dites, i kerkuar nga aksioneret e pakices

Aksioneret, te cilet zoterojne aksione, qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te regjistruar te shoqerise ose nje perqindje me te vogel, te parashikuar ne statut, mund t'u drejtojne administratorëve nje kerkese me shkrim, peshire komunikimin me poste elektronike, per te thirrur asamblene e pergjithshme dhe / ose, jo me vone se 8 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese, te kerkojne perfshirjen e ceshtjeve te caktuara ne rendin e dites. Ne kerkese duhet et jepen arsyet dhe objektivat, si dhe ceshtjet per te cilat duhet et marre vendime asambleja e pergjithshme. Nese kerkesa nuk eshte pranuar, keta ortake kane te drejte te therrasin asamblene e pergjithshme e te vendosin ceshtje ne rendin e dites, ne perputhje me piken 1 te nenit 137 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Nese asambleja e pergjithshme , ne kundërshtim me piken 1 te ketij neni, nuk thirret, ose ceshtja e kerkuar prej ketyre nuk perfshihet ne rendin e dites, secili prej aksionereve, qe ka bere kerkesen, ka te drejte :

- o Te ngreje padi ne gjykate per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise, nese organet drejtuese nuk permbushin kerkesat e tyre brenda 15 diteve.
- o T'i kerkojne shoqerise blerjen e aksioneve te zoteruara prej tyre, sipas nenit 133 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Ne rastet kur rendi i dites ndryshohet, sipas parashikimeve te pikes 1 te ketij neni dhe thirja u eshte njoftuar ortakeve, administratorët njoftojne perseri rendin e dites, ne te njejtat menyra me et cilat eshte kryer njoftimi i pare.

Neni 16 Perfaqesimi ne asamble

1. Nje aksioner mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje aksioner tjetër apo nga nje person i trete.
2. Administratorët dhe anetaret e keshillit te administrimit apo te keshillit mbikeqyres nuk mund te veprojne si perfaqesues te aksionereve be asamblene e pergjithshme.
3. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

-
4. Perfaqesuesi i autorizuar eshte i detyruar te deklaroje cdo fakt apo rrethane, te tille qe, sipas gjykimit te aksionerit te perfaqesuar, rrezikon te ndikoje ne vendimmarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere te ndryshem nga ata te aksionetit perfaqesuar.

Neni 17 Pjesemarrja me mjete komunikimi elektronike

Ky statut parashikon pe raksioneret, qe nuk jane te pranishem, mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndrushme komunikimi, perfshire mjetete elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:

- o Trasnsmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale .
- o Videokoferencat.
- o Komunikimin e ndersjelle, i cili u mundeson ortakeve te shprehen ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme ne kohe reale, nga nje vendodhje tjeter.
- o Mekanizma qe mundesojne procesin e votimit, perpara apo gjate mbledhjes se asamblese se pergjithshme , pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.

Perdorimi i mjeteve elektronike, per t'u mundesuar aksionereve marrjen pjese ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, behet me kusht qe te merren masat teknike, te nevojshme per et garantuar identifikimin e tyre dhe sigurine e komunikimeve elektronike deri ne ate mase qe ky perdorim te jete proporcional me arritjen e ketyre qellimeve.

Neni 18: Kuorumi

Në rastin e çështjeve , që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishem ose të perfaqesuar aksioneret, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve , me et drejte vote. Kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 145 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse aksioneret që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me te drejte vote,apo perfaqesuesit e tyre, marrin pjese ne votim personalisht ose j votojnë me shkresë, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të ligjit.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur ne piken 1 te ketij neni , asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 19: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë me tre të katërtat e votave të aksionereve, në qoftese marrin pjesë aksioneret, që zoterojnë me shume se gjysmen e numrit total të aksioneve me të drejte vote.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera me shumicën e votave të aksionereve që marrin pjesë.

Aksioneri që zoteron 51 % të kapitalit aksioner, ka të drejte e votes për operacionet e mëposhtme :

- a) blerja, apo tjetërsimi imobiliar apo i të drejtave reale imobiljare;
- b) Nenshkrimi i hipotekave për objektet imobiljare të shoqërisë.
- c) Emetimi i borxhit obligacionar.
- d) Operacione financiare mbi kembime apo kurse kembimi.
- e) Heqja e kuatave të shoqërisë personave të treta, jo të pranueshme.
- f) Hapja e filialeve apo degëve në territorin shqiptar.
- g) Debitimi i shoqërisë, nëpërmjet mjeteve të debitit.

Neni 20: Te drejtat e votës

Cdo aksioner i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

Aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote. Në këtë rast, aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë me shume se 49 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Ndalohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre me shume të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson.

Neni 21 ;

Aksioneri humbet cilësinë e të qenit aksioner në shoqëri në rastet kur:

- a) Deklarohet falimentuar. Apo në procedurë të tjera gjyqësore falimentimi.
- b) Deklarohet pa zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

-
- c) Kur ka qene I denuar me vendim te forms se prere, me te pakten 5 vjet heqje lirie.

Neni 22 **Keshilli i Administrimit. Funkzioni, Kompetencat dhe Shperblimi**

Keshilli i administrimit ka keto te drejta dhe pergjegjesi:

- a) Te jape direktiva per administratoret per zbatimin e politikave tregetare te shoqerise.
- b) Te kontrolloje e te mbikeqyre zbatimin e politikave tregetare te shoqerise nga administratoret.
- c) Te pergatise, me kerkese et asamblese se pergjithshme, marrjen e masave, qe jane ne competence te kesaj et fundit, t'i rekomandoje asaj vendive et nevojshme per t'u marre, si dhe te zbatoje vendimit e asamblese.
- d) Te therrase mbledhjen e asamblese se pergjithshme, sa here vleresohet e nevojshme per interest e shoqerise.
- e) Te kujdeset qe shoqeria te respektoj ligjin dhe standartet e kontabilitetit.
- f) Te shqyrtoj e te kontrolloje librat kontabel, dokumentet dhe aktivet e shoqerise.
